

Vendim nr. 292 datë 27.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 27.11.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 3 (GJ) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **GJON KURTI, TEREZINA BARDHI, FEDERIK KURTI**, përfaqësuar nga avokat Lorval Petani dhe avokat Esmeralda Rama (Dregjoni), me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4943 (674), datë 22.11.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 2, 6, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesit Gjon Kurti, Terezina Bardhi dhe Federik Kurti, sipas dëshmisë noteriale të trashëgimisë ligjore nr. 2013 rep. dhe nr. 600/1 kol., datë 18.10.2017, janë fëmijët dhe

njëherazi dhe trashëgimtarët ligjorë të shtetas Ç.K, e cila ka ndërruar jetë në datën 15.09.2017, ndërsa ka qenë në cilësinë e të paditurës në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar nga ata përmes ankimit kushtetues individual. Nga ana tjetër, trashëgimlënësja e kërkuesve (Ç.K.) dhe vëllai i saj N.H. janë trashëgimtarë ligjorë të babait të tyre P.H. (gjyshi i kërkuesve). Ky i fundit është një nga trashëgimtarët ligjorë të babait të tij M.H.

2. Trashëgimlënësi M.H. (stërgjyshi i kërkuesve), krahas P.H., ka lënë si trashëgimtarë ligjorë edhe dy fëmijë të tjerë, djalin Z.H. dhe vajzën D.H., ku i pari në vijim ka lënë si trashëgimtar ligjor të birin S.H., krahas bashkëshortes T.B., ndërsa kjo e fundit më pas ka lënë si trashëgimtar ligjor të birin S.H. Nga ana tjetër, trashëgimtarja D.H. ka lënë në vijim si trashëgimtare ligjore vajzën e saj M.T.C. (me shtetësi italiane). Fillimisht, me dëshminë noteriale të trashëgimisë të datës 15.11.1993, si trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënësit M.H. janë përcaktuar T.B. dhe S.H. (respektivisht bashkëshortja dhe djali i trashëgimtarit Z.H.), si dhe C.K. dhe N.H. (fëmijët e trashëgimtarit P.H.). Më pas, mbi kërkesën e trashëgimtarit S.H., Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 71, datë 14.01.2008, ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin M.H. duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të tij krahas T.B., S.H., C.K. dhe N.H., edhe mbesën M.T.C. (fëmija e trashëgimtares D.H.).

3. Trashëgimlënësi M.H. ka pasur në pronësi, ndër të tjera, një truall me sipërfaqe 352 m², të ndodhur në lagjen nr. 4 të qytetit të Durrësit, me kufizime të përcaktuara. Me vendimin nr. 522, datë 26.06.1994, bazuar në ligjin nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës ish-pronarëve” (ligji nr. 7698/1993), Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Durrës (KKKP-ja, Durrës) ka njohur të drejtën e pronësisë mbi atë sipërfaqe trualli, duke ia kthyer si të lirë trashëgimtarëve të tij sipas dëshmisë noteriale të trashëgimisë të datës 15.11.1993, konkretisht shtetasve T.B., S.H., C.K. dhe N.H. Në bazë të këtij vendimi trualli është regjistruar në regjistrat publikë në pronësi të trashëgimtarëve në fjalë të M.H.

4. Me kontratën e sipërmarrjes nr. 103/87, datë 23.01.2007, të lidhur me shoqërinë e ndërtimit “E.” sh.p.k., bashkëpronarët C.K. e N.H. kanë rënë dakord për ndërtimin nga ajo shoqëri të një pallati banimi në truallin në bashkëpronësi të tyre dhe të shtetasve T.B. dhe S.H. Në vijim, Këshilli i Rregullimit të Territorit i Bashkisë Durrës (KRRT-ja e Bashkisë Durrës) me vendimin nr. 4, datë 11.09.2006, ka miratuar destinacionin e sheshit të ndërtimit dhe kondicionet urbane të tij edhe në truallin e familjes “H.”, për objektin 12 kate, ndërsa me vendimin e tij nr. 6, datë 26.10.2006 ka miratuar lejen e ndërtimit në favor të shoqërisë “E.” sh.p.k., me afat vlefshmërie deri në datën 13.08.2011.

5. Ndërkohë, pas lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit M.H., me vendimin nr. 71, datë 14.01.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, trualli në fjalë është regjistruar në pronësi të trashëgimtarëve të përcaktuar në atë vendim, konkretisht të shtetasve M.T.C., S.H., C.K. dhe N.H. Në vijim, mes shtetasve M.T.C., nga njëra anë dhe shtetasve S.H., C.K. dhe N.H., nga ana tjetër, ka lindur një mosmarrëveshje pronësie për sa i përket pasurisë truall të trashëguar dhe të drejtave të rrjedhura prej saj. Për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje, në datën 22.12.2011 shtetasja M.T.C. ka vënë në lëvizje gjykatën me një kërkesëpadi, duke paditur shtetasit S.H., C.K. dhe N.H, si dhe shoqërinë “E.” sh.p.k., me të cilën ka kërkuar detyrimin e tyre ta njohin pronare për pjesën takuese të sipërfaqes ndërtimore të objektit të ndërtuar edhe mbi truallin në bashkëpronësi të saj, si dhe detyrimin e tyre t’ia dorëzojnë fizikisht pjesën e saj takuese të sipërfaqes ndërtimore sipas raportit të shkëmbimit truall me ndërtim të familjes “H.” në atë objekt ndërtimor.

6. Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 1941(11-2013-3715), datë 15.07.2013, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke detyruar të paditurit S.H., N.H., Ç.K. dhe shoqërinë “E.” sh.p.k. të njohin paditësen M.T.C. si pronare për pjesën takuese të sipërfaqes ndërtimore banim prej 58,33 m² në objektin shumëkatësh të ndërtuar sipas lejes së ndërtimit nr. 6, datë 26.10.2008 të KRRT-së të Bashkisë Durrës, në emër të shoqërisë “E.” sh.p.k., si dhe detyrimin e tyre t’i japin fizikisht dhe të lirë asaj këtë sipërfaqe ndërtimore sipas përcaktimeve të ekspertit. Ajo gjykatë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se palët ndërgjyqëse janë bashkëpronarë të pasurisë truall, fituar përmes trashëgimisë ligjore nga trashëgimlënësi M.H., ndaj paditësja M.T.C., duke qenë bashkëpronare në këtë pasuri, gëzon të drejtën e përfitimit të sipërfaqes ndërtimore njësoj si dhe bashkëpronarët e tjerë të paditur. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim të paditurit C.K. (trashëgimlënësja e kërkuësve) dhe N.H.

7. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 425(10-2015-992), datë 29.04.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë. Gjykata e apelit, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se paditësja nuk legjitimohet në lidhje me kërkimet e objektit të padisë, pasi padia në rastin konkret është një padi njohje (vërtetimi) e së drejtës dhe jo padi detyrimi, sikurse është trajtuar nga gjykata e shkallës së parë. Sipas asaj gjykate, paditëses i mungon interesi i ligjshëm në ngritjen e padisë, pasi nuk disponon një titull pronësie të vlefshëm, ndërkohë që nuk ka paraqitur padi për kërkimin e trashëgimit në kuptim të neneve 349 dhe 350 të Kodit Civil (KC), nuk ka kundërshtuar vendimin e KKKP-së, Durrës me të cilin prona u është kthyer trashëgimtarëve T.B., S.H., C.K. dhe N.H. dhe as ka kërkuar detyrimin e të paditurve ta njohin bashkëpronare mbi atë pasuri. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs paditësja M.T.C.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-4943 (674), datë 22.11.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ai kolegji, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se edhe pse paditësja në padinë e saj ka kërkuar njohjen e saj pronar dhe dorëzimin e pjesës përkatëse të pasurisë në ndërtimin e realizuar, në thelb, kërkonte i saj ka të bëjë me njohjen e bashkëpronësisë mbi një pasuri të njohur dhe kthyer nga komisioni i pronave dhe përfitimin e të drejtave që rrjedhin nga kjo bashkëpronësi të njëjta si ato të bashkëpronarëve të tjerë, palët e paditura në këtë gjykim. Sipas tij, pasuria objekt gjykimi është kthyer me vendim të komisionit të ngarkuar nga ligji për kthimin e pronës, i konsideruar si organ *quasi gjyqësor*, përmes të cilit është disponuar në favor të ish-pronarit M.H., duke qenë përfitues të gjithë trashëgimtarët e tij, përfshirë edhe paditësja, duke qenë kështu i pambështetur në ligj përfundimi i gjykatës së apelit për mungesën e legjitimitetit aktiv të paditëses ndërsa e drejta e saj e pronësisë gjenerohet nga trashëgimia.

9. Në datën 30.09.2024, sipas shërbimit postar, kërkuetit kanë paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuetesve

10. **Kërkuetit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar:

10.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

10.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe parimit të të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me provat e administruara në gjykim, por edhe me ligjin material dhe procedural, duke treguar qartazi njëanshmëri në favor të paditëses. Ajo gjykatë, edhe pse në prani të dy vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta që e kanë trajtuar çështjen në mënyrë të ndryshme, e ka zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, duke mos arsyetuar në bazë të provave dhe duke mos ushtruar rolin e saj si gjykatë ligji. Gjykata e shkallës së parë dhe, më pas, edhe Gjykata e Lartë kanë arsyetuar se paditësja është pronare bazuar në dëshminë e trashëgimisë, duke neglizhuar faktin se të paditurit e kanë fituar pronën në bazë të vendimit të KKKP-së, Durrës dhe e kanë regjistruar atë në hipotekë, ndërkohë që paditësja nuk ka ndërmarrë asnjë proces administrativ apo gjyqësor për kundërshtimin e këtij vendimi, të drejtë të cilën ajo tashmë e ka humbur

ndërsa kanë kaluar 30 vjet nga dhënia e vendimit dhe krijimit të pasojave nga ai.

- 10.1.2. *Së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën e ankimit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur parasysh kërkesat e ligjit procedural të kohës së paraqitjes së rekursit, konkretisht nenin 482 të KPC-së, në lidhje me njoftimin e palëve për ditën dhe orën e gjykimit, ndërsa nuk ka bërë afishimin e shpalljes dhe as njoftimin individual të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, ndërkohë që të paditurit C.K. dhe N.H. kishin ndërruar jetë disa vjet përpara se ajo gjykatë të shqyrtonte rekursin e tyre.
- 10.1.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë, me vendimin e saj, në mënyrë indirekte, ka shfuqizuar pjesërisht titullin e pronësisë së të paditurve, pikërisht vendimin e KKKP-së, Durrës, titull i cili nuk ka më vlerë juridike, pavarësisht se ai është në fuqi dhe nuk ka asnjë akt ligjor që ta ketë shfuqizuar atë.
- 10.1.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka analizuar dhe nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve në rekurs të të paditurve, por ka pranuar të mirëqenë të drejtën e pronës së paditëses, duke i bërë të dyja palët pronare me dy tituj pronësie të ndryshëm.
- 10.1.5. Gjykata e Hkallës së Parë dhe në vijim edhe Gjykata e Lartë kanë vepruar në kundërshtim me ligjin procedural dhe atë material, pasi kanë pranuar të mirëqenë faktin se paditësja ka titull pronësie vetëm mbi dëshminë e trashëgimisë, e cila nuk përbën titull pronësie, duke pranuar kështu, në kundërshtim me ligjin, padinë e saj për lirim dhe dorëzim sendi, megjithëse i mungonte interesi i ligjshëm. Me vendimet e tyre ato gjykata kanë bërë që për të njëjtën pronë të ketë dy tituj pronësie, megjithëse nuk ka asnjë vendim gjyqësor për anulimin e vendimit të KKKP-së, Durrës të dhënë në favor të të paditurve. Ato gjykata kanë pranuar padinë megjithëse paditësja nuk mund të kërkojë pjesë takuese në ndërtim pa u deklaruar e pavlefshme kontrata e sipërmarrjes. Gjykatat janë bazuar në përfundimet e ekspertimit, të cilat janë të pasakta, konfuze, tërësisht të njëanshme dhe të paligjshme. Po ashtu, ato gjykata, pa u mbështetur në ligj dhe prova, kanë rrëzuar prapësimin e të paditurve se vendimi nr. 71, datë 14.01.2008 i Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është një vendim deklarativ i gabuar,

ndërsa paditësja nuk ka vërtetuar se është trashëgimtare e nënës së saj D.H., për sa kohë nuk ka një certifikatë vdekjeje të kësaj të fundit.

10.2. *E drejta e pronës private*, pasi të paditurit janë zhveshur në një pjesë të së drejtës së tyre pa një proces të rregullt ligjor, si pasojë e vendimmarrjes së paligjshme të Gjykatës së Lartë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuësve

11. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kolegji vlerëson se kërkuësit, si bartës të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, sepse janë trashëgimtarë ligjorë të një prej palëve ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

13. Kërkuësit plotësojnë edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, pasi objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për rrjedhje ata nuk kanë mjet tjetër ligjor për të shteruar për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara, përveç kërkesës në këtë Gjykatë.

14. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose

me njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesit është dhënë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në datën 22.11.2023, kurse ankimi kushtetues individual është dërguar në Gjykatë në datën 30.09.2024, përmes shërbimit postar. Me informacionin e datës 14.10.2024, Gjykata e Lartë ka sqaruar se vendimi i kundërshtuar nga kërkuesit është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 20.05.2024, datë nga e cila është bërë i disponueshëm për palët. Në lidhje me respektimin e afatit ligjor për paraqitjen e ankimit të tyre kushtetues individual, kërkuesit kanë parashtruar se ankimi, në datën 09.09.2024, sipas kopjes së letrës së porositur, është depozituar gabimisht në Gjykatën e Lartë dhe pasi u është kthyer mbrapsht nga kjo e fundit me shkresën nr. 4533/1 prot., datë 25.09.2024, marrë në dorëzim nga ata në datën 30.09.2024, menjëherë po në këtë datë, përmes shërbimit postar, i është dërguar Gjykatës. Aktet shkresore në fjalë kërkuesit ia kanë bashkëlidhur kërkesës.

16. Nën dritën e rrethanave si më lart, si dhe duke mbajtur parasysh standardet e vendosura në lidhje me momentin e marrjes dijeni të vendimit që përbën mjetin e fundit ankimor, por edhe rregullimin e bërë në nenin 27, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit në rast se kërkesa është dërguar gabimisht në një institucion tjetër ajo konsiderohet e paraqitur në afat, në rast se provohet se kjo ka ndodhur në mirëbesim, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor dhe kërkuesit legjitimohen *ratione temporis*.

17. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën e ankimit, parimit të sigurisë juridike, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit, si dhe të së drejtës së pronës private.

18. Lidhur me cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, kërkuesit, në thelb, kanë pretenduar se Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me provat e administruara në gjykim, por edhe me ligjin material e procedural, duke treguar qartazi njëanshmëri në favor të paditëses.

19. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e paanshme. E drejta për një gjykatë të paanshme nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëjës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të

paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin subjektiv, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes apo interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin objektiv, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 11, datë 02.04.2008; nr. 23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në lidhje me këtë pretendim (cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme), Kolegji konstaton se kërkuesit nuk kanë parashtruar ndonjë argument kushtetues qoftë për sa i përket testit subjektiv, ashtu edhe testit objektiv. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuesve nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Për sa i takon pretendimit *për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë, edhe pse në prani të dy vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta që e kanë trajtuar çështjen në mënyrë të ndryshme, e ka zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, duke mos arsyetuar në bazë të provave dhe duke mos ushtruar rolin e saj si gjykatë ligji.

22. Kolegji vëren se neni 482 i KPC-së përcakton se shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit. Ndërkohë, neni 482/a, pika 1, i po këtij kodi përcakton se Gjykata e Lartë, në dhomën e këshillimit, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve nëse çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, apo e vlerëson të nevojshme, për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes. Gjykata në këtë drejtim ka theksuar se vlerësimi nëse çështja duhet të shqyrtohet në dhomë këshillimi ose në seancë publike u përket vetë kolegjeve të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 38, datë 22.02.2023; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, përderisa kërkuesit nuk kanë paraqitur ndonjë argument kushtetues pse çështja duhej të shqyrtohej në prani të palëve, edhe ky pretendim i tyre është haptazi i pabazuar.

23. Kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e *së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën e ankimit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur parasysh kërkesat e ligjit procedural të kohës së paraqitjes së rekursit, konkretisht nenin 482 të KPC-së, në lidhje me njoftimin e palëve për ditën dhe orën e gjykimit, ndërsa nuk ka bërë afishimin e shpalljes dhe as njoftimin individual të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, ndërkohë që të paditurit C.K. dhe N.H kishin ndërruar jetë disa vjet përpara se ajo gjykatë të shqyrtonte rekursin e tyre.

24. Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se është detyrë e palëve që të ndjekin ecurinë e gjykimit të çështjes së tyre në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr. 47, datë 06.07.2015; nr. 13, datë 04.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për sa u takon pretendimeve për ligjin procedural të zbatueshëm lidhur me procedurën e njoftimit, edhe pse kërkuesit argumentojnë se duhej zbatuar ligji i kohës së depozitimit të rekursit, në fakt, në kërkesën e tyre i referohen pikës 3 të nenit 482 të KPC-së sipas përmbajtjes së saj të ndryshuar me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, e cila është e njëjtë me përmbajtjen aktuale të kësaj pike pas ndryshimeve të kësaj dispozite me ligjin nr. 44/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Ndërsa në lidhje me procedurat e njoftimit, Kolegji konstaton se neni 480 i KPC-së parashikon shqyrtimin e rekursit në lidhje me kushtet e pranueshmërisë në dhomën e këshillimit. Më tej, në rastin kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë dokumentesh (neni 482 i KPC-së) ose në prani të palëve (neni 482/a i KPC-së), shqyrtim për të cilin palët njoftohen për ditën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, përmes shpalljes në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit (neni 482/a, pika 2, i KPC-së).

26. Në rastin në shqyrtim, nga të dhënat e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rubrika “Çështje të shpallura për gjykim”, për kategorinë “Çështje civile”, nën rubrika “Për shqyrtim në dhomë këshillimi”, rezulton se në datën 06.11.2023 është shpallur lista e çështjeve për shqyrtim në datën 22.11.2023, ora e seancës, si dhe përbërja e trupit gjykues për çdo çështje, në të cilën pasqyrohet edhe çështja e kërkuesve.

27. Në këndvështrim të sa më sipër, në kushtet kur nga dokumentacioni i sjellë bashkëlidhur kërkesës nuk konstatohet që të jenë lënë të dhënat elektronike të kontaktit, Kolegji vlerëson se, pavarësisht se ligji procedural nuk përcakton në mënyrë të shprehur detyrim për Gjykatën e Lartë për njoftimin e palëve për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit në kuadër të verifikimit të kriterëve të pranueshmërisë së tij, ajo gjykatë i ka njoftuar palët sipas

rregullave të përgjithshme të njoftimit që ligji procedural ka përcaktuar për të, duke iu bërë të ditur atyre datën dhe orën e shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, çka bën që ky pretendim i kërkuesve të jetë haptazi i pabazuar.

28. Kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e parimit të sigurisë juridike për sa i përket vendimit të KKKP-së, Durrës dhe se gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Lartë kanë vepruar në kundërshtim me ligjin procedural dhe material në lidhje me këtë vendim të KKKP-së. Referuar thelbit të argumenteve të parashtruara nga kërkuesit në lidhje me këto pretendime, Kolegji vëren se ato kanë të bëjnë me qëndrimin e mbajtur nga gjykatat në vendimet objekt kundërshtimi, ndaj ato do të trajtohen në kuadër të pretendimit tjetër të kërkuesit, atij për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Po ashtu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës së pronës private, argumentet për të cilin janë të ndërvarura me atë për cenimin e procesit të rregullt ligjor, ndaj Kolegji vlerëson se çështja duhet të trajtohet në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona private nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës private ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Për rrjedhojë, duke mbajtur në konsideratë argumentet e paraqitura nga kërkuesi, Kolegji vlerëson që pretendimet më lart të tij të trajtohen në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

29. Kërkuesit kanë pretenduar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e aksesit, pasi Gjykata e Lartë nuk ka analizuar dhe nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve në rekurs të të paditurve, por ka pranuar të mirëqenë të drejtën e pronës së paditëses, duke i bërë të dyja palët pronare me dy tituj pronësie të ndryshëm. Gjykata e shkallës së parë dhe në vijim edhe Gjykata e Lartë kanë vepruar në kundërshtim me ligjin procedural e atë material, pasi kanë pranuar të mirëqenë faktin se paditësja ka titull pronësie vetëm mbi dëshminë e trashëgimisë, e cila nuk përbën titull pronësie, duke pranuar kështu, në kundërshtim me ligjin, padinë e saj për lirim dhe dorëzim sendi, megjithëse i mungon interesi i ligjshëm. Me vendimet e tyre ato gjykata kanë bërë që për të njëjtën pronë të ketë dy tituj pronësie, megjithëse nuk ka asnjë vendim gjyqësor për anulimin e vendimit të KKKP-së, Durrës të dhënë në favor të të paditurve. Ato gjykata kanë pranuar padinë megjithëse paditësja nuk mund të kërkojë pjesë takuese në ndërtim pa u deklaruar e pavlefshme kontrata e sipërmarrjes. Gjykatat janë bazuar në përfundimet e ekspertimit, të cilat janë të pasakta, konfuze, tërësisht të njëanshme dhe të paligjshme. Po ashtu, ato gjykata, pa u mbështetur në ligj dhe prova, kanë

rrëzuar prapësimin e të paditurve se vendimi nr. 71, datë 14.01.2008 i Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është një vendim deklarativ i gabuar, ndërsa paditësja nuk ka vërtetuar se është trashëgimtare e nënës së saj D.H., për sa kohë nuk ka një certifikatë vdekjeje të kësaj të fundit. Në këtë mënyrë Gjykata e Lartë, me vendimin e saj, në mënyrë indirekte, ka shfuqizuar pjesërisht titullin e pronësisë së të paditurve, pikërisht vendimin e KKKP-së, Durrës, titull i cili nuk ka më vlerë juridike, pavarësisht se ai është në fuqi dhe nuk ka asnjë akt ligjor që ta ketë shfuqizuar atë.

30. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se nëse mohohet e drejta e aksesit, procesi konsiderohet i parregullt, sepse ajo, para së gjithash, është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 16, datë 23.03.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata është shprehur se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradikcion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit për qëllime të procesit gjyqësor është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndërsa detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Bazuar në standardet kushtetuese të mësipërme, Kolegji do të verifikojë, mbështetur në materialet e çështjes, nëse pretendimet e kërkuësve në rastin konkret janë ose jo haptazi të

pabazuara, pra nëse kërkuesit kanë marrë ose jo përgjigje nga gjykatat e zakonshme për pretendimet e tyre, nëse arsyetimi i vendimeve të gjykatave të zakonshme është ose jo i mjaftueshëm, si dhe nëse interpretimi nga ato i ligjit ka qenë ose jo eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës.

34. Në kuptim të sa më sipër, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë, ndërsa ka pranuar padinë e kërkueses, ka arsyetuar se palët ndërgjyqëse janë bashkëpronarë të pasurisë truall, fituar përmes trashëgimisë ligjore nga trashëgimlënësi M.H., ndaj paditësja M.T.C., duke qenë bashkëpronare në këtë pasuri, gëzon të drejtën e përfitimit të sipërfaqes ndërtimore njësoj si dhe bashkëpronarët e tjerë të paditur.

35. Gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e padisë duke arsyetuar se paditësja nuk legjitimohet në lidhje me kërkimet e objektit të padisë, pasi padia në rastin konkret është një padi njohje (vërtetimi) e së drejtës dhe jo padi detyrimi, sikurse është trajtuar nga gjykata e shkallës së parë. Sipas asaj gjykate, paditëses i mungon interesi i ligjshëm në ngritjen e padisë, pasi vendimmarrja e KKKP-së, Durrës ka gjeneruar gjendjen juridike të bashkëpronësisë mbi truallin midis trashëgimtarëve T.B., S.H., C.K. dhe N.H., ndaj fakti që kjo pasuri në vitin 2008 është regjistruar edhe në favor paditëses, nuk prezumon ekzistencën e së drejtës së saj të bashkëpronësisë mbi truallin ish-pronë të M.H., për sa kohë kjo e drejtë nuk është konfirmuar sipas procedurës së parashikuar nga ligji nr.7698/1993 dhe aktualisht ligji nr. 9235/2004, çka do të thotë se paditësja nuk disponon një titull pronësie të vlefshëm, sipas kuptimit të nenit 163 të *KC-së*, i cili të jetë regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme dhe të tregojë të drejtën e saj mbi atë sipërfaqe trualli. Po sipas saj, paditësja nuk ka paraqitur padi për kërkimin e trashëgimit në kuptim të neneve 349 dhe 350 të *KC-së*, nuk ka kundërshtuar vendimin e KKKP-së, Durrës, me të cilin prona u është kthyer trashëgimtarëve T.B., S.H., C.K. dhe N.H. dhe as ka kërkuar detyrimin e të paditurve ta njohin bashkëpronare mbi pasurinë truall.

36. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ai kolegji ka arsyetuar se edhe pse paditësja në padinë e saj ka kërkuar njohjen e saj pronare dhe dorëzimin e pjesës përkatëse të pasurisë në ndërtimin e realizuar, në thelb, referuar edhe vendimit unifikues nr. 3, datë 29.03.2012 të Gjykatës së Lartë, rezulton se kërkimi i saj ka të bëjë me njohjen e bashkëpronësisë mbi një pasuri të njohur dhe kthyer nga komisioni i pronave dhe përfitimin e të drejtave që rrjedhin nga kjo bashkëpronësi të njëjta si ato të bashkëpronarëve të tjerë, palët e paditura në këtë gjykim. Sipas tij, pasuria objekt gjykimi është pasuri e fituar para reformës agrare dhe e kthyer me vendim të komisionit të ngarkuar nga ligji për kthimin e pronës, i konsideruar si organ *quasi gjyqësor* sipas vendimit unifikues nr. 24, datë 13.03.2002 të

Gjykatës së Lartë, por edhe vendimit nr. 27, datë 26.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese, vendim përmes të cilit komisioni ka disponuar në favor të ish-pronarit M.H., duke qenë përfitues të gjithë trashëgimtarët e tij, përfshirë edhe paditësja. Në këto kushte, sipas Gjykatës së Lartë, për sa kohë është provuar e drejta e bashkëpronësisë mes paditëses dhe të paditurve, është i pambështetur në ligj përfundimi i gjykatës së apelit për mungesën e legjitimitetit aktiv të paditëses, pasi e drejta e saj e pronësisë gjenerohet nga trashëgimia, duke mos përbërë titull pronësie as vendimi i komisionit dhe aq më tepër dëshmia e trashëgimisë ligjore e vitit 1993. Po ashtu, argumenton ajo gjykatë, vërtet paditësja ka kërkuar njohjen si pronare, por kërkimi kryesor në padi konsiston në njohjen e bashkëpronësisë dhe përfitimit/rivendikimit të pjesës së saj takuese, e cila i mbahet pa të drejtë nga të paditurit, kërkim i cili me të drejtë është pranuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila në një gjykim kontradiktor, pasi ka njohur pronësinë, ka disponuar edhe mbi të drejtat e fituara nga paditësja nga kjo bashkëpronësi, duke i dhënë sipërfaqen përkatëse të banimit.

37. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se duke iu referuar në tërësi pretendimeve të kërkuesve, fakteve në rastin konkret dhe standardeve kushtetuese, rezulton se ata ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat e zakonshme në lidhje me pretendimet e ngritura në rekurs. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i Gjykatës së Lartë pasqyrojnë mjaftueshëm faktet dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me njohjen e bashkëpronësisë së palës paditëse, sikundër edhe argumentet e gjykatave në lidhje me qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Po ashtu, Gjykata e Lartë, në rolin e saj si gjykatë e ligjit, i ka dhënë përgjigje kërkuesit në lidhje me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit material e procedural, të aplikueshëm në rastin e tij. Në këndvështrim të standardit të arsytimit, Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit të paraqitura nga rekursuesja, ka arsyetuar se përse duhet të vendoset lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në këtë kuptim në procesin gjyqësor të kundërshtuar nga kërkuesi nuk konstatohen shkelje të të drejtave kushtetuese dhe as që zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme të ketë qenë arbitrar, pra që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë sipas nenit 42 të Kushtetutës.

38. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor nuk gjen mbështetje në materialet e çështjes, ndaj ky pretendim është haptazi i pabazuar.

39. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesve nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.